

RUBRIKA I
E DREJTA KUSHTETUESE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Teza 1

I. Rrethoni alternativën e saktë:

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si:

- a) gjinia
- b) gjinia, kur vendoset nga Gjykata Kushtetuese
- c) gjinia, kur vendoset nga Gjykata e Lartë
- d) gjinia, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive

2. E drejta për të marrë dhe dhënë informacion është një e drejtë:

- a) Absolute
- b) E kufizuar sipas parashikimeve të nenit 17 të Kushtetutës
- c) E kufizuar sipas parashikimeve të akteve nënligjore
- d) E kufizuar vetëm në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

3. Askush nuk mund t'i nënshtrohet trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës:

- a) përveç rastit kur akuzohet për krimin e gjenocidit
- b) përveç rastit kur akuzohet për kryerjen e akteve terroriste
- c) në asnjë lloj rrethane apo situatë
- d) përveç rastit kur akuzohet nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për krime kundër njerëzimit

4. Avokati i Popullit, kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike:

- a) bën rekomandime
- b) vendos dëmshpërblimin
- c) fillon procedimin disiplinor
- d) vendos sanksione me gjobë

5. Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga:

- a) çdo deputet
- b) një grup prej jo më pak se 10 deputetësh
- c) Kryetari i Kuvendit
- d) një grup prej jo më pak se 20 deputetësh



6. Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, vendin e zë dhe i ushtron kompetencat e tij:

- a) Avokati i Popullit
- b) Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
- c) Kryeministri
- d) Kryetari i Kuvendit

7. Miratohet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit ligji për:

- a) buxhetin e shtetit
- b) taksat dhe tatimet
- c) ndarjen administrative të Republikës
- d) arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë

8. Kuvendi është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë, me kërkesë të:

- a) Një së tretës së të gjithë anëtarëve të tij
- b) Një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij
- c) Një së pestës së të gjithë anëtarëve të tij
- d) Një së gjashtës së të gjithë anëtarëve të tij

9. Të drejtën për të propozuar ligje e kanë edhe:

- a) 10 mijë zgjedhës
- b) 20 mijë zgjedhës
- c) 30 mijë zgjedhës
- d) 40 mijë zgjedhës

10. Kuvendi mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, me kërkesë të:

- a) Këshillit të Ministrave
- b) Një të tretës së të gjithë deputetëve
- c) Një të katërtës së të gjithë deputetëve
- d) Kryetarit të Kuvendit

11. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi me shumicën e:

- a) votave në prani të jo më pak se gjysma plus një e të gjithë anëtarëve
- b) të gjithë anëtarëve të tij
- c) jo më pak se tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij
- d) jo më pak se dy të tretave të të gjithë anëtarëve të tij



12. Mund të shtrohen në referendum çështje që lidhen me:

- a) taksat e detyrimet financiare të shtetit
- b) territorin
- c) mjedisin
- d) amnistinë

13. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga:

- a) 3/5 e të gjithë anëtarëve të tij
- b) 2/3 e të gjithë anëtarëve të tij
- c) shumica e të gjithë anëtarëve të tij
- d) shumica e votave në prani të jo më pak se gjysmës plus një e të gjithë anëtarëve

14. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga:

- a) Presidenti Republikës
- b) Kryeministri
- c) Kryetari i Kuvendit
- d) jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit

15. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor shkarkohet nga:

- a) Gjykata Kushtetuese
- b) Gjykata e Lartë
- c) Kuvendi
- d) Presidenti i Republikës



RUBRIKA 2
E DREJTA ADMINISTRATIVE

Teza 3

I. Gjени përgjigjen e saktë:

16. Cili nga aktet administrative kërkon detyrimisht miratimin e tij me një tjetër akt administrativ?

- a) vendimi;
- b) udhëzimi;
- c) rregullorja;
- d) urdhëresa.

17. Sipas Kodit të Procedurave Administrative:

- a) organet publike kompetente nuk mund të delegojnë kompetencat e tyre ligjore te një organ tjetër publik;
- b) organet publike kompetente nuk mund të delegojnë kompetencat e dhëna me ligj ose me akte nënligjore tek organet e tyre vartëse;
- c) organet kolegjiale të administratës publike mund t'i delegojnë kompetencat e tyre në favor të drejtuesve të tyre;
- d) organi i deleguar ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes delegimit.

18. Në Kodin e Procedurave Administrative, e drejta e informimit:

- a) nuk përmendet, sepse rregullohet vetëm nga ligji i posaçëm;
- b) ushtrohet vetëm nga palët në një procedurë administrative;
- c) kushtëzohet nga detyrimi për të respektuar ruajtjen e sekretit shtetëror sipas kufizimeve ligjore dhe të dhënat personale sipas legjislacionit përkatës;
- d) kërkon në çdo rast që kërkuesi të shpjegojë motivet e kërkesës.

19. Procedura administrative deklarohet e braktisur:

- a) nëse pala e interesuar, për faj të saj, ka qenë pasive për një periudhë jo më shumë se 1 muaj nga paraqitja e kërkesës për fillimin e procedurës;
- b) nëse pala e interesuar, për faj të saj, ka qenë pasive për më shumë se 60 ditë nga paraqitja e kërkesës;
- c) kur pala e interesuar tërheq kërkesën, pavarësisht se organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik;
- d) edhe kur pala ka qenë pasive pa fajin e saj.



20. Akti individual i Këshillit të Ministrave fillon të sjellë pasoja juridike për subjektin:

- a) kur atij i njoftohet përmbajtja;
- b) kur botohet në Fletoren Zyrtare;
- c) ditën e miratimit të aktit;
- d) në datën e caktuar nga vetë akti, edhe nëse subjekti nuk është njoftuar.

21. Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet kur:

- a) organi publik ndryshon vlerësimin e tij për çështjen;
- b) shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar ose eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve ose sigurisë publike;
- c) pala e tretë paraqet kundërshtime ndaj aktit;
- d) kanë kaluar 30 ditë nga dita e nxjerrjes së tij.

22. Paditë për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës paraqiten në gjykatën administrative:

- a) sipas afateve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm;
- b) brenda 45 ditëve nga data e njoftimit;
- c) brenda 30 ditëve nga lindja e mosmarrëveshjes;
- d) jo më vonë se 45 ditë nga ezaurimi i ankimit administrativ.

23. Gjatë gjykimit incidental, gjykata administrative:

- a) është e detyruar të zbatojë aktin nënligjor normativ edhe kur e çmon të paligjshëm;
- b) ia dërgon aktin nënligjor normativ Gjykatës Kushtetuese;
- c) nuk zbaton aktin nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se ai është i paligjshëm;
- d) nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor.

24. Sipas LGJA, mosparaqitja e palëve në seancë gjyqësore:

- a) nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit;
- b) i jep të drejtë gjykatës të pushojë gjykimin;
- c) shtyn detyrimisht gjykimin në një datë tjetër;
- d) detyron gjykatën të marrë mendimin e palës tjetër.

25. Për marrjen nga gjykata administrative të masës së sigurimit të padisë kërkohet:

- a) të plotësohen domosdoshmërisht tre kushte, përfshirë edhe pagimin e garancisë në çdo rast;
- b) të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet: mundësia e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin, si dhe moscenimi i rëndë i interesit publik;
- c) të plotësohet vetëm njëri nga dy kushtet;
- d) të paguhet vetëm garancia, pa qenë e nevojshme ekzistenca e kushteve të tjera.



26. Komisioneri i Shërbimit Civil është:

- a) organ që shqyrton ankesat e nëpunësve civilë si hallkë ankimi para atij gjyqësor;
- b) institucion që mbikëqyr zbatimin e ligjit "Për nëpunësin civil";
- c) organ quasi-gjyqësor për funksionet që kryen;
- d) strukturë vartëse e Departamentit të Administratës Publike (DAP).

27. Masën disiplinore "vërejtje" në shërbimin civil e jep:

- a) titullari i institucionit;
- b) drejtorja e personelit;
- c) komisioni disiplinor;
- d) eprori direkt.

28. Kur vërtetohet se është cenuar parimi i paanësisë për shkak të konfliktit të interesit, aktet administrative në kuptim të KPA-së:

- a) janë absolutisht të pavlefshme,
- b) konsiderohen si akte të paligjshme,
- c) duhet fillimisht të ushtrohet ankimi administrativ te organi,
- d) vetëm duhet të deklarohen si të pavlefshme në gjykatë.

29. Që mbledhja e Këshillit të Bashkisë të jetë e vlefshme proceduralisht, ndër të tjera, duhet të jenë të pranishëm në mbledhje:

- a) të gjithë anëtarët,
- b) 2/3 e të gjithë anëtarëve,
- c) të pakën shumica e të gjithë anëtarëve,
- d) asnjë prej rregullave më sipër nuk është e vlefshme.

30. Marrëveshja e pagesës me këste për gjobën administrative:

- a) bëhet me gojë para organit administrative;
- b) lidhet nga gjykata që shqyrton ankimin;
- c) nuk mund të parashikojë afate më të gjata se 6 muaj nga data e nënshkrimit;
- d) mbetet në fuqi edhe kur nuk paguhet në afat një këst i vetëm.



RUBRIKA 3
E DREJTA CIVILE

TEZA 4

31. Kur fitohet pronësia me përpunim?

- a) Personi që me punën e tij ka krijuar një send të ri të luajtshëm duke përdorur lëndën në pronësi të një personi tjetër, bëhet pronar i sendit të ri në rast se vleftha e punës është më e madhe se ajo e lëndës, me kusht që të paguajë vlefshësin e saj.
- b) Personi që krijon një send të ri të luajtshëm me lëndën e tij të parë, por mbi një send të paluajtshëm që është në pronësi të një personi tjetër bëhet pronar i sendit të ri në rast se vleftha e punës dhe e materialeve të jetë të paktën e barabartë me atë të sendit të paluajtshëm.
- c) Personi që me punën e tij ka krijuar një send të ri të luajtshëm duke përdorur lëndën në pronësi të një personi tjetër, bëhet pronar i sendit të ri në rast se vepra e krijuar prej tij ka origjinalitet dhe spikat për karakteristikat e saj individuale.
- d) Personi që krijon një send të ri të luajtshëm me lëndën e tij të parë, por mbi një send të paluajtshëm që është në pronësi të një personi tjetër bëhet pronar i sendit të ri pavarësisht nëse ka vepruar me mirëbesim apo keqbesim.

32. Cila është forma e shfaqjes së vullnetit për kryerjen e një veprimi juridik?

- a) Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim ose me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.
- b) Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim ose me gojë.
- c) Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.
- d) Veprimi juridik mund të kryhet vetëm me shkrim ose me veprime konkludente.

33. Kur ngrihet padia e begatimit pa shkak?

- a) Padia për begatimin pa shkak mund të ngrihet edhe kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar.
- b) Padia për begatimin pa shkak mund të ngrihet vetëm kur i dëmtuari është begatuar nga një marrëdhënie kontraktore ekzistuese.
- c) Padia për begatimin pa shkak mund të ngrihet vetëm kur i dëmtuari nuk mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar.
- d) Padia e begatimit pa shkak ngrihet vetëm kur begatimi ka ndodhur me fajin e të begatuarit

34. Çfarë ndodh kur testamenti deklarohet i pavlefshëm nga gjykata?

- a) Kur testamenti deklarohet i pavlefshëm, në trashëgim thirren trashëgimtarët e radhës së parë.
- b) Kur testamenti deklarohet i pavlefshëm, në trashëgim thirren trashëgimtarët ligjorë.
- c) Kur testamenti deklarohet nga gjykata i pavlefshëm, në trashëgim thirret shteti.
- d) Kur testamenti deklarohet nga gjykata i pavlefshëm, në trashëgim thirret bashkëshorti.



35. Kur konsiderohet i paligjshëm shkaku i kontratës?

- a) Shkaku i kontratës që vjen në kundërshtim me interesin ekonomik të paktën të njërës nga palët është i paligjshëm.
- b) Shkaku i kontratës që vjen në kundërshtim me ligjin dhe moralin quhet shkaku i paligjshëm.
- c) Shkaku i kontratës që vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme.
- d) Shkaku i kontratës që vjen në kundërshtim me kushtet sociale të palëve është i paligjshëm.

36. Si shlyhet një detyrim që është i pjesëtueshëm që ka shumë debitorë?

- a) Secili debitor është i detyruar të ekzekutojë një pjesë të barabartë të detyrimit, përveç kur në kontratë ose në ligj është parashikuar ndryshe.
- b) Secili debitor duhet të ekzekutojë të gjithë detyrimin, nëse i kërkohet nga kreditori dhe më pas të kërkojë pjesët respektive të debitorëve të tjerë.
- c) Secili debitor është i detyruar të ekzekutojë vetëm pjesën e tij, në rast se ajo është më e vogël se e debitorëve të tjerë.
- d) Secili debitor është i detyruar të ekzekutojë vetëm pjesën e tij, kur është më e madhe se e debitorëve të tjerë.

37. Kur konsiderohet si pezullues kushti i parashikuar nga palët në një kontratë?

- a) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet shuhen po të ndodhë ngjarja.
- b) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet nuk shuhen po të ndodhë ngjarja.
- c) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet pezullohen nëse do të ndodhë ngjarja.
- d) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet lindin po të ndodhë ngjarja.

38. Afati i emërimit të administratorit në një SHPK nuk mund të jetë:

- a) Më i gjatë se 5 vite;
- b) Më i gjatë se tre vite;
- c) Përcaktohet në statut por jo më shumë se 5 vite;
- d) Asnjë prej tyre.

39. Shoqëria kolektive prishet automatikisht nëse:

- a) Largohet një nga ortakët;
- b) Vdes një nga ortakët;
- c) Mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar;
- d) Asnjë prej tyre.

40. Veprimtaria tregtare e një shoqërie komandite administrohet nga:

- a) Një ose më shumë ortak të pakufizuar;
- b) Një ose më shumë ortak të kufizuar;
- c) Nga ortakët e pakufizuar dhe të kufizuar së bashku;
- d) Asnjë prej tyre.



RUBRIKA 4
PROCEDURA CIVILE

TEZA 17

41. Gjени alternativën e saktë:

- a) Padi të për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri.
- b) Padi të për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi.
- c) Padi të për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në cilëndo gjykatë që dëshiron paditësi.
- d) Padi të për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre.

42. Gjени alternativën e saktë:

- a) I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, në përpjesëtim me pjesën e refuzuar të padisë.
- b) I padituri nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, edhe në rast të refuzimit të padisë.
- c) I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, edhe në rast të refuzimit të pjesëshëm të padisë.
- d) I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, në përpjesëtim me pjesën e pranuar të padisë.

43. Gjени alternativën e saktë:

- a) Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur e përcakton gjykata.
- b) Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur ligji e parashikon shprehimisht.
- c) Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur e kërkojnë shprehimisht palët.
- d) Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur është në dobi të gjykimit.

44. Gjени alternativën e saktë:

- a) Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, si dhe shpenzimet për kryerjen e ekspertimit.
- b) Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.
- c) Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet vetëm tarifa, ndërsa shpenzimet e nevojshme për njoftimet paguhen nëse pala e paditur paraqitet në gjykim.
- d) Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhen vetëm shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, ndërsa tarifa paguhet nëse gjykata vendos rrëzimin e padisë.



45. Gjени alternativën e saktë:

- a) Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes.
- b) Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pranimin e padisë, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes.
- c) Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se nuk ka dijeni për gjykimin, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes.
- d) Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos rrëzimin e padisë, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes.

46. Gjени alternativën e saktë:

- a) Me pëlqimin e palës paditëse personi i tretë që ka ndërhyrë vetë ose është thirrur në gjykatë nga njëra prej palëve, mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit të dalë jashtë gjykimit.
- b) Me pëlqimin e palës së paditur personi i tretë që ka ndërhyrë vetë ose është thirrur në gjykatë nga njëra prej palëve, mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit të dalë jashtë gjykimit.
- c) Me pëlqimin e të dy palëve personi i tretë që ka ndërhyrë vetë ose është thirrur në gjykatë nga njëra prej palëve, mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit të dalë jashtë gjykimit.
- d) Me pëlqimin e të dy palëve si dhe me dhënien e një shpërblimi të drejtë personi i tretë që ka ndërhyrë vetë ose është thirrur në gjykatë nga njëra prej palëve, mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit të dalë jashtë gjykimit.

47. Gjени alternativën e saktë:

- a) Gjukata, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij.
- b) Gjukata i cakton kryesisht ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij dhe më pas vendimin ua komunikon palëve për të marrë mendimin e tyre.
- c) Gjukata, pasi merr edhe mendimin e palës që ka kërkuar kryerjen e ekspertimit, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij.
- d) Gjukata, në rastet kur ka vlerësuar kryesisht nevojën për kryerjen e ekspertimit, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij, pa marrë më parë mendimin e palëve.



48. Gjени alternativën e saktë:

- a) Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që nuk ndikojnë në zgjidhjen e çështjes, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj.
- b) Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj, por pala kishte vlerësuar të mos i paraqiste në gjykim.
- c) Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj.
- d) Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që nuk ka marrë ende formë të prerë, kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj.

49. Gjени alternativën e saktë:

- a) Kur humbet ose zhduket vetë titulli ekzekutiv dhe nuk ka mundësi që përmbajtja e tij të nxirret nga aktet e organeve që kanë lëshuar titullin ekzekutiv, kreditori humbet të drejtën e tij ndaj debitorit.
- b) Kur humbet ose zhduket vetë titulli ekzekutiv dhe ka mundësi që përmbajtja e tij të nxirret nga aktet e organeve që kanë lëshuar titullin ekzekutiv, kreditori mund të ngrejë padi kundër përmbartuesit, sipas rregullave të përgjithshme.
- c) Kur humbet ose zhduket vetë titulli ekzekutiv dhe nuk ka mundësi që përmbajtja e tij të nxirret nga aktet e organeve që kanë lëshuar titullin ekzekutiv, kreditori mund të ngrejë padi kundër debitorit dhe të kërkojë prej tij ekzekutimin vullnetar të detyrimit.
- d) Kur humbet ose zhduket vetë titulli ekzekutiv dhe nuk ka mundësi që përmbajtja e tij të nxirret nga aktet e organeve që kanë lëshuar titullin ekzekutiv, kreditori mund të ngrejë padi kundër debitorit, sipas rregullave të përgjithshme.

50. Gjени alternativën e saktë:

- a) Ekzekutimi pezullohet kur përmbartuesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, gjen pasuri të debitorit pasi kalimit të 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit.
- b) Ekzekutimi pezullohet kur përmbartuesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen pasuri të debitorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit.
- c) Ekzekutimi pezullohet kur përmbartuesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, gjen pasuri të debitorit, por ato nuk janë të mjaftueshme për të ekzekutuar të gjithë detyrimin.
- d) Ekzekutimi pezullohet kur përmbartuesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e debitorit, nuk gjen pasuri të kreditorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit.



RUBRIKA 5
E DREJTA FAMILJARE

TEZA NR. 13

I. Rrethoni alternativën e saktë:

51. Në zgjidhjen e martesës gjykata shprehet për fajësinë:

- a) Në çdo rast;
- b) Me kërkesë të bashkëshortëve;
- c) Me kërkesë të prokurorit;
- d) Nuk mund të shprehet sepse fajësia nuk përfshihet në rregullimet e Kodit të Familjes.

52. Veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës:

- a) Është pjesë e bashkësisë ligjore në çdo rast;
- b) Nuk është pjesë e bashkësisë ligjore nëse në kapitalin themeltar kontribuon vetëm njëri bashkëshort;
- c) Është pjesë e bashkësisë nëse kontributet e investuara në kapital janë fituar gjatë martesës;
- d) Është pasuri vetjake nëse të ardhurat e investuara janë fituar para martesës.

53. I mituri që për shkaqe me rëndësi lejohet nga gjykata të lidhë martesë nën moshë:

- a) Ka si regjim pasuror atë të pasurive të ndara;
- b) Ka si regjim pasuror atë të bashkësisë ligjore;
- c) Ka si regjim pasuror atë të bashkësisë me kontratë;
- d) Ka të drejtë të zgjedhë regjimin më të përshtatshëm për të.

54. Marrja e masave të përkohshme në rastin e zgjidhjes së martesës:

- a) Bëhet nga gjykata kryesisht;
- b) Bëhet nga gjykata me kërkesë të prokurorit;
- c) Bëhet nga gjykata me kërkesë të palës së interesuar;
- d) Masat e marra lidhur me pasurinë dhe përdorimin e pasurisë së vënë gjatë martesës kanë karakter të përhershëm.

55. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM) nga dhuna në familje lëshohet nga:

- a) Nga gjykata ku ka vendbanimin/vendqëndrimin viktimi e dhunës në familje ose dhunuesi/ja;
- b) Struktura përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit;
- c) Struktura përgjegjëse pranë qendrës shëndetësore të zonës ku banon viktimi e dhunës në familje;
- d) Struktura përgjegjëse pranë njësisë vendore të zonës ku banon viktimi e dhunës në familje.



RUBRIKA 6
E DREJTA E PUNËS

Teza 2

56. Zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme:

- a) kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë;
- b) për shkak të pjesmarrjes së punëmarrësit në veprimtari sindikale në përputhje me ligjin;
- c) kur punëmarrësi ka refuzuar kryerjen e nje detyre tjetër të ngarkuar nga punëdhënësi të parashikuar në përshkrimin e punës së kontratës së punës;
- d) punëmarrësi ushtron një të drejtë kushtetuese.

57. Nëse punëmarrësi nuk e kryen punën zakonisht në të njëjtin shtet, por tërësia e rrethanave për kryerjen e saj tregojnë lidhje të ngushta me një shtet të caktuar, kontrata e punës rregullohet nga:

- a) ligji shqiptar i punës;
- b) ligji i shtetit në të cilin punëmarrësi kryen më së shumti punën/detyrat e tij;
- c) ligji i shtetit me të cilin kontrata e punës paraqet lidhje më të ngushta;
- d) ligji ku ndodhet qendra e punëdhënësit.

58. Organizata profesionale e fiton personalitetin juridik:

- a) pas 30 ditëve nga dorëzimi i statutit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë;
- b) pas 30 ditëve nga vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për regjistrimin e saj;
- c) pas 60 ditëve nga dorëzimi i statutit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë;
- d) pas 60 ditëve nga vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për regjistrimin e saj.

59. Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha nga:

- a) ora 08.00 e ditës së hënë deri në orën 16.00 të ditës së premte të asaj jave;
- b) ora 08.00 e ditës së hënë deri në orën 14.00 të ditës së premte të asaj jave;
- c) ora 0 e ditës së hënë deri ditën e dielë ora 24.00 të asaj jave;
- d) ora 0 e ditës së hënë deri ditën e hënë ora 08.00 e javës së ardhshme.

60. Të miturit nga mosha 15 deri 16 vjec mund të punësohen në punë të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre:

- a) pa pëlqimin e prindit apo kujdestarit;
- b) vetëm pas dhënies së pëlqimit nga prindi ose kujdestari;
- c) me pëlqimin e organit përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës, Inspektoratin Shtetëror të Punës;
- d) pas kontrollit mjekësor të posaçëm të kryer para fillimit të punës.



RUBRIKA 7
E DREJTA PENALE

Teza 10

61. Vjedhja konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese kur:

- a) Objekti material i vjedhjes është pasuria shtetërore;
- b) Kjo veprë penale ka sjellë pasoja të rënda;
- c) Është kryer duke shpërdoruar funksionin publik;
- d) Është kryer ndaj një personi të pambrojtur.

62. Vepra penale kryhet me dashje direkte kur:

- a) Personi e ka kryer veprën duke i parashikuar pasojat e veprës penale, por ka menduar se do të shmangë ardhjen e tyre;
- b) Personi që ka kryer veprën penale ka parashikuar pasojat e veprës penale dhe i ka dëshiruar;
- c) Personi që ka kryer veprën penale ka parashikuar pasojat e veprës penale dhe nuk i ka dëshiruar ato, por me ndërjegje ka lejuar ardhjen e tyre;
- d) Personi që ka kryer veprën penale nuk i ka parashikuar dhe as dëshiruar pasojat e veprës penale, megjithëse sipas rrethana ai duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte.

63. Përdorimi i ligjshëm i armëve të zjarrit është shkak përjashtues nga përgjegjësia penale nëse:

- a) Personi që përdor ose urdhëron përdorimin e armëve ose të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës, nuk ka qenë i detyruar nga nevoja për të përmbushur detyrën sipas ligjit;
- b) Përdorimi i armëve të zjarrit dhe mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nuk është mjeti i domosdoshëm;
- c) Çdo person i cili ndihmon zyrtarin publik, edhe pa kërkesën e ligjshme të këtij të fundit ka përdorur armën e zjarrit;
- d) Personi që përdor ose urdhëron përdorimin e armëve ose të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës, ka qenë i detyruar nga nevoja për të përmbushur detyrën sipas ligjit.

64. Identifikoni pohimin e saktë mbi figurat e veprave penale:

- a) Tek "Largimi nga vendi i aksidentit" motivi merr rëndësi për cilësimin juridik të veprës;
- b) Tek "Trafikimi i narkotikëve" ardhja e pasojës kalimi i kufirit merr rëndësi për cilësimin juridik të veprës;
- c) "Korrupsioni pasiv i gjyqtareve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë" mund të kryhet edhe nëpërmjet propozimit të një përfitimi të parregullt, funksionarëve të drejtësisë;
- d) Tek "Moskallëzimi i krimit" moskallëzimi mund të konsumohet edhe përpara kryerjes së krimit.

65. Me veprën penale të mashtrimit kuptojmë:

- a) Përvetësimi i pasurisë përmes paraqitjes së fakteve të rreme;
- b) Mosekzekutimin në afatin e caktuar të një detyrimi civil të njohur gjyqësisht;
- c) Përvetësimin e pasurisë, përmes shpërdorimit të detyrës të personit subjekt i kësaj veprë penale;

- d) Marrjes së një sendi në përdorim të përkohshëm, sipas afatit të përcaktuar në kontratë, dhe mospranimi i kthimit të tij, pa përfunduar afati i dakordësuar.

66. Vepra penale e shkatërrimit të pronës karakterizohet nga:

- a) Shkaktimi i një dëmi material në pronën private ose publike;
- b) Subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm – personi që ka detyrimin të ruajë e të mirëmbajë pronën;
- c) Kjo vepër penale që të konsiderohet e kryer kërkon si elementë të domosdoshëm ekzistencën e motiveve apo të qëllimit kriminal;
- d) Për cilësimin e kësaj vepre penale dëmi i shkaktuar duhet të jetë i konsiderueshëm.

67. Kryerja e veprës penale në bashkëpunim, nënkupton që:

- a) Ndihmësit mbajnë përgjegjësi më të madhe se ekzekutorët;
- b) Marrëveshja është një nga elementët e domosdoshëm për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale;
- c) Ndihmësit dhe shtytësit mbajnë përgjegjësi të njëjtë;
- d) Shtytësit dhe ndihmësit mbajnë përgjegjësi penale edhe në rast se vepra penale nuk kryhet.

68. Kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

- a) Shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në dhjetë muaj;
- b) Zvogëlimin e kësteve të pagimit të gjobës;
- c) Kryerjen e një pune me interes publik;
- d) Direkt zëvendësimin e gjobës me burgim.

69. Objekti i veprave penale në fushën e doganave janë:

- a) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar importimin dhe eksportimin e mallrave në pikat e kalimit kufitar;
- b) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë;
- c) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj, nga shmangia e detyrimeve doganore;
- d) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar mbrojtjen e interesave ekonomike të Republikës së Shqipërisë nga çdo veprim i kundraligjsëhm që synon shmangien e detyrimeve doganore.

70. Objekt i veprave penale në shoqëritë tregtare janë:

- a) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar interesat e ligjshme të shtetit, duke garantuar veprimtarinë e rregullt e korrekte të administratës publike;
- b) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në marrëdhëniet juridiko-civile;
- c) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt e korrekte të personave që ushtrojnë funksione drejtuese në sektorin privat;
- d) Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar interesat e ligjshme të personave fizikë nga veprimet e kundërligjshme të personave të tretë.

RUBRIKA 8
PROCEDURË PENALE

TEZA 5

71. Ndër masat e sigurimit personal, me natyrë shtrënguese, përfshihet edhe:

- a) ndalimi ose detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar;
- b) sekuestroja preventive;
- c) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive profesionale ose afariste;
- d) pezullimi i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore;

72. Në përmbajtje të fashikullit të gjyqimit nuk përfshihen:

- a) aktet që i përkasin kërkesës për pranimin e padisë civile;
- b) dëshmia e penalitetit dhe dokumente të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit;
- c) procesverbalet për veprimet e këqyrjes, njohjes dhe eksperimentimit;
- d) pyetja e personave që kanë dijeni mbi rrethanat e hetimit.

73. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori është i detyruar të procedojë me plotësimin e kërkesës së parashtruar nga mbrojtja, në rastin kur:

- a) kërkohet të pyetet një dëshmitar;
- b) kërkohet të kryhet rikëqyrja e vendit të ngjarjes;
- c) kërkohet që i pandehuri të merret në pyetje;
- d) kërkohet që hetimet të pushohen për mungesë të faktit penal.

74. Në rastin e marrjes në pyetje të personit, pasi ndaj tij është vendosur dhe ekzekutuar masa e sigurimit “ndalim për dalje jashtë shtetit”, marrja në pyetje nga gjykata duhet të kryhet:

- a) brenda afatit prej 72 orësh;
- b) brenda 3 ditëve nga zbatimi i masës;
- c) brenda 5 ditëve nga zbatimi i masës;
- d) ligji nuk parashikon kryerjen e këtij veprimi.

75. Kur gjatë seancës paraprake del se akuza nuk është formuluar qartë, atëhere gjykata:

- a) e riformulon akuzën kryesisht dhe vë në dijeni të pandehurin;
- b) fton prokurorin që të formulojë qartë akuzën;
- c) në çdo rast, vendos t'i kthejë aktet prokurorit dhe njofton drejtuesin e prokurorisë;
- d) vendos dërgimin e çështjes në gjyq, por shprehet për paqartësinë e akuzës në dispozitivin e vendimit.



76. Lidhur me vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake është i vërtetë pohimi:

- a) kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq lejohet ankimi në gjykatën e apelit;
- b) gjyqtari i seancës paraprake në asnjë rast nuk mund të vendosë pushimin e çështjes;
- c) nuk është në tagrin e gjyqtarit të seancës paraprake shqyrtimi i kërkesave për pavlefshmërinë e akteve;
- d) kur palët paraqesin marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, çështja shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake.

77. Përgjimi i bisedimeve ose komunikimeve lejohet kur hetohet për krimin e vrasjes, në rastet kur:

- a) vrasja kryhet me dashje;
- b) asnjëherë;
- c) edhe në rastin e vrasjes nga pakujdesia;
- d) në rastin c), por me autorizim të prokurorit.

78. Viktima akuzuese ka të drejtë t'i kërkojë:

- a) prokurorit, fillimin e procedimit penal;
- b) gjykatës, gjykimin e personit të akuzuar;
- c) policisë gjyqësore, arrestimin e autorit të veprës penale;
- d) prokurorit, ta mbështesë atë në mbledhjen e provave të nevojshme që vërtetojnë fajësinë.

79. Kompetenca tokësore përcaktohet, në radhë të parë:

- a) nga vendbanimi i të pandehurit,
- b) nga vendi i arrestimit ose të ndalimit të personit të dyshuar;
- c) nga vendi ku ka ardhur pasoja e veprës penale;
- d) nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale.

80. Cilësia e të pandehurit merr fund atëherë kur:

- a) jepet vendimi i dënimit në shkallën e parë;
- b) gjyqtari miraton urdhrin penal të dënimit;
- c) vendimi i dënimit merr formën e prerë;
- d) vendoset rigjykimi i çështjes nga gjykata më e lartë.



RUBRIKA IX

E DREJTA E BE-SË DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

TEZA 10

81. Institucioni me karakter ndërqeveritar në BE është:

- a) Komisioni Europian
- b) Këshilli i Bashkimit Europian
- c) Parlamenti Europian
- d) Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

82. Në bazë të vendimeve të GJED-së *Van Gend & Loos dhe Costa v. Enel*

- a) E drejta e BE-së mbështet në të drejtat kushtetuese të shteteve anëtare
- b) E drejta e BE-së zbatohet plotësisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha shtetet anëtare, dhe u jap të drejta dhe u vendos detyrime shteteve anëtare, dhe qytetarëve të tyre.
- c) E drejta e BE-së u drejtohet vetëm shteteve anëtare
- d) a+b

83. Është qëllim i Bashkimit Europian:

- a) Krijimi i një forcë ushtarake që mbrojnë shtetet anëtare dhe ato candidate
- b) Krijimi i një zone lirie sigurie dhe drejtësie, pa kufij ku garantohet lëvizja e lirë
- c) Krijimi i një zhvillimi të qëndrueshëm që mbrojnë natyrën dhe ekosistemin
- d) Krijimi i një ekonomie që bazohet të tregu i lirë

84. Bashkimi Europian:

- a) nuk mund të jetë palë në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut
- b) është palë në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut
- c) traktati ndalon aderimin e BE-së në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut
- d) është në proces për tu bërë palë në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut

85. Shtetet Anëtare mund të kufizojnë të drejtat e lëvizjes së lirë për:

- a) Shkaqe ekonomike
- b) Shkaqe mjedisore
- c) Shkak të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik
- d) Shkaqe arsimore



86. Një nga qëllimet e MSA është:

- a) Krijimi i një zone të tregtisë së lirë
- b) Krijimi i një monedhe të përbashkët
- c) Krijimi i një sistemi të përbashkët bankar
- d) Krijimi i një unioni ushtarak

87. Sipas jurisprudencës së GJDBE-së, konsiderohen “punëtorë”:

- a) Ata që punojnë me kohë të plotë në tregun e BE-së
- b) Ata që punojnë në institucione publike të shteteve anëtare
- c) Ata që kryejnë aktivitet real dhe efektiv kundrejt shpërblimit
- d) Asnjëra prej tyre

88. Tarifat doganore ndërmjet shteteve anëtare:

- a) Lejohen në raste të veçanta
- b) Vendosen nga shtetet
- c) Zbatohen vetëm për mallrat luksoze
- d) Janë plotësisht të ndaluara

89. Juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është:

- a) Fakultativ;
- b) I detyrueshëm;
- c) I detyrueshëm vetëm në rastet kur konflikti midis shteteve e paraqet para gjykatës Këshilli i Sigurimit ose Asambleja e Përgjithshme e OKB-së;
- d) b + c.

90. Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB:

- a) Janë të detyrueshme në çdo rast;
- b) Janë të detyrueshme vetëm kur Këshilli i Sigurimit ndërhyt për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare në kuadër të Kapitullit VII të Kartës së OKB;
- c) Janë të detyrueshme edhe në rastet kur Këshilli u rekomandon palëve në mosmarrëveshje që çështjen ta zgjidhin me mjete paqësore;
- d) Janë të detyrueshme vetëm kur Këshilli i Sigurimit vendos në kuadër të Kapitullit VI të Kartës së OKB-së.



RUBRIKA X

ETIKA

TEZA 1

I. Rrethoni alternativën e saktë:

91. Cili organ i miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre:

- a) Këshilltari i Etikës;
- b) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- c) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- d) Ministria e Drejtësisë

92. Këshilltari i Standardeve të Etikës dhe Rregullave të Sjelljes së Prokurorit caktohet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- c) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- d) Kuvendi i Shqipërisë.

93. Cili parim etik, pohon që "avokati duhet të jetë i lirë nga çdo ndikim që mund të lindë nga interesat e tij personale ose nga presioni i jashtëm":

- a) Parimi i dinjitetit profesional;
- b) Parimi i pavarësisë;
- c) Parimi i përkushtimit dhe aftësisë;
- d) Parimi i paanshmërisë.

94. A mundet që banesa apo një ambient privat në posedim faktik prej gjyqtarit të përdoret nga:

- a) Avokati;
- b) Eksperti;
- c) Prokurori;
- d) Asnjëri

95. Prokurori është i pavarur nga pushtetet e tjera dhe grupet e interesit. Por prokurori duhet të jetë i pavarur dhe nga:

- a) Gjyqtarët;
- b) Prokurorët;
- c) Avokatët;
- d) Noterët.



96. Detyrimi i konfidencialitetit nuk shkelet kur:

- a) Avokati informon një person të cilit ai është duke i deleguar detyrat individuale për shërbime ligjore mbi ecurinë e çështjes në fjalë, me kusht që edhe një person i tillë t'i nënshtrohet detyrimit të konfidencialitetit;
- b) Tregon konfidenca ose sekrete me pëlqimin e klientit ose të klientëve në fjalë, por vetëm pasi t'ua tregojë plotësisht atyre këtë gjë;
- c) Tregon konfidenca ose sekrete të nevojshme për të caktuar ose marrë pagesën e avokatit ose për të mbrojtur avokatin ose nëpunësit e tij, ose ortakët kundër një akuze për sjellje të gabuar;
- d) Të gjitha më sipër.

97. Gjyqtari në respekt të dinjitetit të funksionit, paanshmërisë dhe pavarësisë, lirshëm dhe me dëshirë pranon kufizime personale në lirinë e: shprehjes, besimit, tubimit, organizimit, veshjes etj., që mund të shihen si të paarsyeshme për një qytetar të thjeshtë:

- a) Shprehjes;
- b) Tubimit;
- c) Veshjes;
- d) Të gjitha më sipër.

98. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit përbëhen nga:

- a) Tërësia e parimeve që udhëheqin sjelljen e prokurorit;
- b) Tërësia e normave që udhëheqin sjelljen e prokurorit;
- c) Tërësia e rregullave gjerësisht të pranueshme që udhëheqin sjelljen e prokurorit;
- d) Të gjitha më sipër

99. Si e shpreh gjyqtari mendimin për vendimin gjyqësor të marrë, vetëm apo në trup gjykues:

- a) Me arsyetimin e vendimit të marrë;
- b) Me komente publike në media;
- c) Me publikime shkencore;
- d) Me komente publike në tryeza akademike.

100. Për të ruajtur reputacionin e mirë të vetës dhe Dhomës së Avokatëve, avokati nuk duhet të tolerojë sjellje jo korrekte dhe me mungesë respekti nga ana e:

- a) Gjyqtarit;
- b) Prokurorit;
- c) Kujtdo tjetër;
- d) Të gjitha më sipër.

